



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1766 Prot.

Durrës, më 09.07.2026

V E N D I M

Nr. 67, Datë 09.07.2026

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 50, DATË 28.05.2026"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; referuar relacionit nr. 1761/1 prot., datë 08.07.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, shkresës së Fakultetit të Biznesit nr. 1764, datë 07.07.2026, vendimit të Senatit Akademik nr.111, datë 08.07.2026, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 50, datë 28.05.2026 të Bordit të Administrimit si më poshtë:
-Miratimin e hapjes së programit të ri të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Accounting", pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit të Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, diplomë e përbashkët me Institutin Politeknik të Braganchës.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 25.000 lekë
3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën **Angleze**.
4. Kodi i programit të studimit: **63BA0411A**.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

